

kut/Rudnik. Por, duke dal nga shtëpia në oborr atë ditë [5.06.1998], Blagojën e qëlluan me pesë plumba në gjoks. Gjete vdekjen në vend. Policia nuk e ka kryer hetimin në vendngjarje, por vetëm e ka bartur trupin e Blagojes në Runik/Rudnik. Blagojen e kanë varrosur më 6.06.1998 në oborrin e kishës në Runik/Rudnik. Dhjetë ditë më vonë, ia vunë zjarrin shtëpisë së tij.

Burimet: deklarata Z.J, FDH-31820; deklarata V.Š, FDH-18312; deklarata L.H, FDH-18987; deklarata P.Č, FDH-5523; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, II, 640, 758; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 60, 905; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 203, FDH-23816; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Sadri (Sefer) Demiri

(3.09.1941, shqiptar nga Syrigana/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor i ndërmarrjes *Ramiz Sadiku*, tre fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar më **8.06.1998** mëhallën shqiptare në Syrganë/Suvo Grlo. Gratë dhe fëmijët e kanë braktisur fshatin, ndërkaq burrat kanë mbetur duke u strehuar nëpër shtëpitë dhe bodrumet. Sadriu me vëllain Enverin qëndronin të fshehur në shtëpinë familjare [Syrganë/Suvo Grlo]. Nga ora 19:00, ushtria e të shtënave u bë shumë e madhe dhe Sadriu dhe Enveri dolën nga shtëpia me qëllim braktisjen e fshatit dhe shkuarjen te familjarët e tyre. Sadriu u nis drejt pyllit, ndërkaq Enveri u kthye dhe hyri në shtëpi që t'i merrte cigaret. Kur në mëngjesin e ditës së nesërme Enveri arriti në Çitak/Çitak, ku strehohej familja e tij, ai mësoi se Sadriu nuk kishte arritur atje dhe se për fatin e tij nuk dihej asgjë. Fati i Sadriut nuk është ndriçuar deri më sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën me numër BLG-803650-01.

Burimet: deklarata E.D, FDH-16653; deklarata A.S, FDH-18964; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Haradin (Avdullah) Uka

(1.03.1910, shqiptar nga Syrigana/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, katër fëmijë)

Rexhep (Ukë) Rexhepi

(19.04.1939, shqiptar nga Syrigana/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, murator, shtatë fëmijë)

Osman (Abedin) Osmani

(10.09.1952, shqiptar nga Syrigana/Suvo Grlo, komuna e Skënderajt/Srbica, veterinar, dy fëmijë)

Haradini jetonte në bashkësi familjare me djemtë Sokolin, Nuredinin dhe Avduhahun, ndërkaq djali i katërt, Samiu, punonte jashtë vendit. Në ditën, kur forcat serbe e sulmuan **Syrganën/Suvo Grlo [8.06.1998]**, Haradini gjendej në shtëpi me të rejën Shehiden, përderisa të bijtë e kishin braktisur fshatin më herët.

Për shkak të sulmeve të forcave serbe, familjet e Osmanit dhe të Rexhepit e kishin braktisur fshatin më herët, ndërkaq ata dy ndenjen në shtëpi. Një ditë para sulmit, ata e kaluan natën te Sejdi Sahiti. Në mëngjes [8.06.1998], Rexhepi dhe Osmani u strehuan në bodrumin e familjes Uka, ku gjendeshin disa dhjeta bashkëfshatarët e tyre të moshuar. Nga ora 13:30, forcat serbe nisën tu vënin zjarrin shtëpive. Tymi filloi të ndjehej dhe, madje, të shihej. Njerëzit që ishin të strehuar në bodrum dolën jashtë me qëllim braktisjen e fshatit. Por, në ato çaste në oborrin e Abit Ukës arritën forcat serbe. Rexhepi arriti që të fshihej në një gropë, prapa shtëpisë së Abit Ukës. Ishte kjo hera e fundit që e shihnin të gjallë. Pjesëtarët e forcave serbe i kanë rrahur me shufra metali Osmanin, Haradinin dhe burra të tjerë. Haradinin e lënduan rëndë. Pastaj, pjesëtarët e forcave serbe i çuan burrat dhe gratë me fëmijët në fshatin fqinj të Cërkolezit/Crkolez. Më pas, u urdhëruan që të ktheheshin në Syrganë/Suvo Grlo. Pas kthimit në fshat, Osmani shkoi në ahurin e tij për ta ushqyer bagëtinë. Nga ai çast, atij i ishte humbur çdo gjurmë.

Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, Haradini nuk ka mundur të kthehej në shtëpi, por me të rejën dhe nipërit vazhduan së ndenjuri në Cërkolez/Crkolez. Nga ky fshat, i biri e ka çuar në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica, ku më 27.09.1998 Haradini ndërroi jetë nga dëmtimet e shkaktuara nga keqtrajtimi i rëndë fizik. E kanë